

VENDIM
Nr.35, datë 30.12.2009

PËR VLEFSHMËRINË E LICENCAVE TË SHA UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit nr.29, datë 8.12.2009, Komisioni Kombëtar

VENDOSI:

1. Të gjithë operatorët që veprojnë në sektorin e furnizimit dhe trajtimit të ujit të pijshëm, si dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, të cilët janë pajisur me licencë nga ERRU përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009, do të vazhdojnë të operojnë me licencat ekzistuese deri në datën e vlefshmërisë së dhënë nga ERRU.

2. Pas përfundimit të vlefshmërisë së licencave ekzistuese, të gjitha subjektet fizike dhe juridike që veprojnë në sektorin e furnizimit dhe trajtimit të ujit të pijshëm, si dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të pajisen me licencë nga ERRU, në përputhje me ligjin e mësipërm, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 dhe rregullores së licencimit nr.29, datë 8.12.2009.

KRYETARI
Avni Dervishi